



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.160/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenkovic - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik “AOME” SH.P.K ; N.T.SH “Tini” -Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë N.T.P “Agoniti”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim i të gjitha shkollave me dru zjarri- Kontratë Publike kornizë” me nr. të prokurimit: 613-020-6243-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Lipjan”, më datën: 23.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “AOME” SH.P.K ; N.T.SH “Tini” –Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim i të gjitha shkollave me dru zjarri- Kontratë Publike kornizë” me nr. të prokurimit: 613-020-6243-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Lipjan”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim i të gjitha shkollave me dru zjarri- Kontratë Publike kornizë” me nr. të prokurimit: 613-020-6243-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Lipjan”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik ankues “AOME” SH.P.K ; N.T.SH “Tini” -Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik ankues “AOME” SH.P.K; N.T.SH “Tini” -Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesën në OSHP, me datë 19.02.2021, me nr. 160/21 , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim i të gjitha shkollave me dru zjarri- Kontratë Publike kornizë” me nr. të prokurimit: 613-020-6243-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “KK-Lipjan”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 59, 52, 65, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.02.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datë: 02.03.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE “AOME” SH.P.K ; N.T.SH “Tini” -Prishtinë

Te nderuar Panel Shqyrtues sa i përket përgjigjeve ne pretendimet ankimore te OE, ankues mendoj se nuk ka nevojë te lëshohem ne hollësira sepse pretendimet ankimore te kësaj ankese janë te njëjta sikurse ankesa e pare qe eshte ushtruar nga OE ,i njëjti ndaj Autoritetit Kontraktues te njëjta, Ankesa e dates.17.12.2020.ankesë për te cilën unë si eksperti shqyrtues kam dhen një raport dhe ju te nderuar keni nxjerr një vendim për këtë lënde ,Vendimi me nr.1111/20 i datës 25.01.2021.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues qe Autoriteti Kontraktues te veproj konform vendimit te OSHP-së me nr.1111/20 i datës 25.01.2021,dhe gjate rivlerësimit te këtë parasysh nenin 1 dhe nenin 6 te LPP-se pasi qe fondet publike duhet te përdorën ne mënyrë ekonomike ashtu siç thekson VENDIMI i OSHP.-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 01.03.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 02.03.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përgjigje ekspertit shqyrtues (AVDUSII BAJARMALIU PËR LËNDËN ME Nr. 160/21 të datës 02.03.2021 (FURNIZIMI I TË GJITHA SHKOLLAVE ME DRU ZJARRI - LIPJAN) Eksperti Shqyrtues i Prokurimit nuk lëshohet me në një ekspertizë të detajuar të lëndës sepse ai këtë e kishte thënë në ekspertizën e pare dhe i drejtohet Panelit Shqyrtues të Prokurimit:

Të nderuar Panel Shqyrtues, sa i përket përgjigjeve në pretendimet ankimore të OE ankues, mendoj se nuk ka nevojë të lëshohem në hollësira sepse pretendimet ankimore të kësaj ankese janë të njëjta sikurse ankesa e pare që është ushtruar nga OE i njëjtë ndaj Autoritetit Kontraktues të njëjtë. Ankesa e datës 17.12.2020, ankesë për të cilën unë si ekspert shqyrtues kam dhënë një raport, dhe ju të nderuar keni marr një vendim për këtë lëndë, Vendimi me nr. 1111/20 i datës 25.01.2021 konstaton : Kjo Llogaritet lëndë e gjykuar – RESJUDICATA

Eksperti Shqyrtues në ekspertizën e vet, të gjitha pikat ankimore të Operatorit Ekonomik ankues i hedhë si të pabazuara (të bashkangjitura në këtë përgjigjeje). PANELI SHQYRTUES Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të kërkesës së AK dhe pretendimit ankimor si dhe shkresave të tjera të bashkangjitura në ankesë, konsideron se AK duhet të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së për referencat dhe të shqyrtoj nëse këto referenca janë të natyrës së njëjtë. AK Komuna e Lipjanit, sa i përket pikës së lartpërmendur, konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ka kërkuar sqarime shtesë nga OL ankues, por edhe pas këtyre kërkesave për sqarime shtesë, OE ankues nuk mund të i plotësoi kërkesat sipas dosjes së tenderit ku thuhet: Operatori Ekonomik duhet të ofroi dëshmi se ka përfunduar me sukses Kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë prej min. 300,000.00 €. Në rast të grupit, lideri duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar furnizime të natyrës së njëjtë. Këtu merret një shembull eklatant nga OE ankues, se Lëndë djegëse „Pelet” është derivat i drurit dhe se referencat e peletit në këtë rast, duhet të merren parasysh. Paneli Shqyrtues sikur bie në lajthitje nga kjo analogji dhe ep shembull se „shumica” e rasteve të

Autoriteteve Kontraktuese i prokurojnë menjëherë në të njëjtin Aktivitet të Prokurimit peletin dhe drurin. Nga kjo, sikur prejudikohet se këto referenca duhet të merren parasysh gjë që për ne dhe për të gjithë njohësit e mirë të qeshjeve të prokurimit, janë të papranueshme. Paneli shqyrtues duhet ta ketë parasysh se AK komuna e Lipjanit ka shpallë dy tender veç e veç:

- Furnizimi i të gjitha shkollave me dru zjarri dhe

- Furnizimi me pelet për shkollat, QKMF-në dhe DKRS-në

Siç po shifet, këta tender, janë të shpallur veç e veç dhe referencat lypsën për secilën veç e veç dhe janë kërkuar referenca ekskluzivisht vetëm për dru (të natyrës së njëjtë). Furnizim me pelet, janë kërkuar referenca të natyrës së njëjtë vetëm për pelet. Po të ishin shpallur të dy tenderët së bashku, atëherë në kërkesat tona do të kërkonim referenca të natyrës së ngjashme për tenderët në fjalë.

Andaj, ne si Autoritet Kontraktues, kërkojmë nga ju të nderuar Panel Shqyrtues i Prokurimit që vendimi i

Edhe disa të dhëna tjera, Nenit 118.4 Nëse Paneli Shqyrtues konstaton se cilado prej pretendimeve nga pretendimet e bëra në ankesë janë të rrejshme, OSHP mund të kërkojë nga parashtruesi i ankesës që të paguaj një gjobë shtesë deri në 5000 €. Në rast të tilla, parashtruesi i ankesës është i papërshtatshëm për pjesëmarrje në çfarëdo mënyre në një aktivitet të prokurimit që mbulohet nga ky ligj përderisa (i) gjoba në fjalë nuk paguhet plotësisht ose një gjykatë me kompetencë e anulon vendimin e OSHP-së për pagimin e gjobës në fjalë. SHPIFJET DHE LAJTHITJET E OE "AOME" SHPK Në listën e referencave futë edhe -Kontratën e papërfunduar me Komunën e Novobërdës me nr. të prok. NB 654 2020 011 121 Në listën e referencave gjenden edhe referencat nga

- KRU „Bifurkacioni” me nr. të prok: 600-20-5267-1-3-6, referenca e datës 14.12.2020.

- K. Regjionale "Uniteti" SH.A. me nr të prok-20-5513-1-3-6, pa datë të lëshimit.

-Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren nr. i prok. 10208-20-3738-1-21 referencë me date 24.11.2020

(në listë, këto referenca gjenden sa për ta vu në lajthitje Autoritetin Kontraktues gjatë vlerësimit)

Për referencën e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, e cila mban datën e një dite mbrapa hapjes së tenderit (23.11.2020) dhe gjoja se kjo është dërguar me date 23.11.2021 përmes platformës elektronike (në fakt kjo është dërguar pas kërkesës për informacione shtesë) Veç tjerash, Operatori Ekonomik "AOME" SHPK merret edhe me shpifje dhe kërcënime (citat) Ju në cilësinë e Zyrtarit të Prokurimit të Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal në Lipjan, Adresa postare Shqipëria 14000, Republika e Kosovës, duhet të jeni të vetëdijshëm se mund të barteni pasojë deri te marrja e përkohshme e certifikatës themelore të profesionalizmit në prokurim si dhe gjobitet Autoriteti kontraktues Kuvendi Komunal në Lipjan Adresa Postale Shqipëria 14000 Republika e Kosovës me shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare (por si duket jeni mësuar me paguar gjoba me mjetet tona - taksa paguesve dhe për këtë nuk mërziteni fare pasi askush nuk mërzitet për këto shpenzimesh të pa arsyeshme). Nëse edhe njëherë vazhdoni me kokëfortësi t'iu përmbaheni qëndrimeve tuaja pa kurrfarë argumentesh dhe mbështetje ligjore do të dorëzojmë Përsëri Ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) Prej nga konstatimi i OE ankues se ne jemi mësuar me paguar gjoba me mjetet e taksapaguesve dhe askush nuk mërzitet me këto shpenzime të pa arsyeshme. D.m.th. për këto gjoba janë në dijeni edhe zyrtarët më të lartë komunal, por që edhe ata nuk mërziten fare (a ka argumente për këto shpifje). Panel i nderuar, kërkoj nga ju që të zbatohet Neni 118.4 në përpikmeri dhe OE "AOME" SHPK për shpifje të tilla, ta merr

dënimin e merituar sipas ligjit të lartpërmendur. Mendoj se janë të plotësuar të gjitha kushtet për zbatimin e Nenit të lartpërmendur.

Nr. ref. Data: 24.11.2020

Në bazë të kërkesës nga Operatori Ekonomik "AOME" Sh.p.k, si dhe duke u bazuar në Raportin e Menaxheri të Kontratës dhe Komisioni të pranimi të datës 23.11.2020 lëshojmë këtë:

REFERENCË / Ë&S Për: "AOME" sh.p.k – Prishtinë. Operatori ekonomik "AOME" sh.p.k - Prishtinë me nr.810848806 është një ndër Operatorët Ekonomik që ka vepruar në Universitetin "Ukshin Hoti"- Prizren, pasi ka lidhur kontratë me titull: "Furnizim me dru Ahu dhe Bungu për ngrohje", me numër të Prokurimit: 10208-20-3738-1-2-1. Vlera e kontratës ka qenë: 11,100.00 Euro. Me anë të kësaj shkrese vërtetojmë se në bazë të kushteve të kontratës si dhe në bazë të raportit të Menaxherit të Kontratës dhe Komisionit të Pranimi të datës 23.11.2020, konfirmohet se të gjitha kushtet e parapara në kontratë janë përmbushur pa probleme. Kjo referencë lëshohet me kërkesën e Operatorit Ekonomik dhe shërben për nevojat: zyrtare të kompanisë.

REFERENC

Operatori ekonomik AOMH SH.P.K me seli Ne Prishtine me nr. identifikues 810848806 ka realizuar punimet për projektin me titull Furnizim me lende djegëse dru për ngrohje ne .KRM UNINITETI SH.A. Mitrovicë ,Me nr. te prokurimit UNIT E11 -20-5515-1-3-6 NE BAZE TE KONTRATES 12.10.2020 me vlerë 3980 ,00euro' Kontraktuesi me përpikëri ju ka përmbajtur kushteve te kontratës si nga aspekti kohor ashtu dhe nga kualiteti . REEBRENCA lëshohet me kërkesën e kompanisë dhe shërbimin për kompletimin e (Dokumentacionin te kompanisë për nevojat e saj.

Data: : ' 14,12.2020

Për: AOME ShPK nga Prishtina

Nga: Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, Bujar Tahiri

Lënda Referencë

Me anë të kësaj Referencë konfirmohet se Operatori Ekonomik AOME SH.P.K nga Prishtina me nr. unik identifikues 810848806 dhe KRU. Bifurkacioni Sh.A Ferizaj kanë nënshkruar kontratë publike me titull: Furnizim me lëndë djegës drunore për ngrohjen e objekteve të KRU Bifurkacioni Sh.A. Ferizaj me nr. prokurimi 600-KRU BIFURKACIONI ShA-20-5267-1-3-6 dhe me nr. te brendshëm 600.20.023.136. në vlerë totale 1.720.00 € (njëmijë e shtatëqind e njëzet Euro),

Kodi Përshkrimi A

02100000-5	i Dru
02110000-8	Dru halore
02150000-0	Dru i butë
20130000-6	Dru i bute i përgatitur
20140000-9	: Dru i forte
20212000-5	■ Dru i petëzuar
20100000-7	i Dru i sharruar

02140000-7 ;Dru të pagdhendura
 20161000-2 i Dru te përpunuara
 02120000-1 |dru tropikale
 02130000-4 Dru zjarri
 20000000-6 Druri, prodhime druri, produkte tape, xunkth dhe xunkthi

Niveli Klasifikimi prind

2 Produkte të Pylltarisë dhe për prerje
 3 Dru
 3 Dru
 3 Dru i sharruar
 3 Flete druri dhe lustra
 3 Dru i sharruar
 4 Dërrasa dhe tablo te drurit
 2 Druri, prodhime druri, produkte tape, xunkth dhe xunkth
 3 Dru
 4 Produktet e përgatitura ose fe përpunuara prej druri
 3 Dru
 3 Dru
 1

Kodi Përshkrimi > Nivel

11100000-1 Naftë (i papërpunuar) 2
 23111000-8 Naftë dhe karburant te aviacionit 4
 11300000-3 Naftë dhe produkte te ngjashme
 23121200-3 Naftë Dizel 5
 11200000-2 Naftë natyrale 2
 23311000-0 Naftë vazeline 4

Numri i përgjithshëm të dhënave të cilat i plotësojnë kriteret e kërkimit: 6.

Klasifikimi prind

1 Benzinë, gazi natyror, naftë dhe produktet të ngjashme
 4 Produkte të lehta dhe te mesme te vajit dhe derivateve
 2 Benzine, gazi natyror, naftë dhe produktet të ngjashme
 5 Vajrat e gazrave
 2 Benzinë, gazi natyror, naftë dhe produktet të ngjashme
 4 Vazeline dhe parafine.

Operatori Ekonomik: "AOME"SH.P.K ; N.T.SH"Timi" -Prishtinë, me datë: 02.03.2021, me anë të parashtrësës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përshëndetje të nderuar, Me datë 01/03/2021 kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së me numër të protokollit 160/21 të datës 01/03/2021, -Raporti i ekspertit shqyrtues që ka të bëjë me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim i të gjitha shkollave me dru zjarri – Kontratë Publike kornizë me numër të prokurimit 613 – 020 – 6243 – 1-1-1 dhe Nr. i brendshëm: 613 /020/121 – 111 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) : Komuna e Lipjanit, është i hartuar në mënyrë profesionale dhe pajtohem me mendimin dhe konstatimet e tij.

Mbetet që në seancën e shqyrtimit kryesor të panelit shqyrtues të OSHP-së, ku do të jetë i pranishëm edhe zyrtari ynë i autorizuar dhe pas shqyrtimit të këtyre pretendimeve ankimore edhe një herë të nxirret Urdhërese nga ania e panelit shqyrtues të OSHP-së për zbatimin e vendimit me numër të protokollit 1111/20 i datës 25/01/2021. Paneli shqyrtues i OSHP-së do të ishte mirë të zbatoj nenin 131 (Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, OSHP ja do të vendosë një gjobë prej jo më pak se pesëmijë (5.000) Euro për autoritetin kontraktues që nuk zbaton një urdhër ose për mos respektimin e urdhrit të OSHP-së brenda pesë(5) ditëve dhe në të njëjtën kohë të kërkoj nga KRPP-ja anulimin e Certifikatës themelore të profesionalizmit në prokurim ose Certifikatën e avancuar të profesionalizmit në prokurim (nëse e posedon) Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i autoritetit përkatës kontraktues. Ju faleminderit për mirëkuptim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.03.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të ankesës së OE ankues, sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr vendim, ku ishte obliguar AK që të kërkoj sqarime shtesë lidhur me referencat konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka zbatuar vendimin e Panelit Shqyrtues, duke kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues, por edhe pas këtyre kërkesave për sqarime shtesë, OE ankues nuk mund të i plotësoi kërkesat sipas dosjes së tenderit. Kërkesë e AK në dosje të tenderit është: Operatori Ekonomik duhet të ofroi dëshmi se ka përfunduar me sukses Kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë prej min. 300,000.00 €. Në rast të grupit, lideri duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar furnizime të natyrës së njëjtë”. Për këtë kërkesë të dosjes së tenderit, Paneli Shqyrtues kishte kërkuar nga AK që gjatë sqarimeve shtesë, të vërtet nëse referencat janë të natyrës së njëjtë. Mirëpo, pas sqarimeve të kërkuara dhe përgjigjes së OE ankues, Paneli Shqyrtues konsideron se “pelet” është lëndë djegëse dhe është derivat i drurit, ashtu siç pretendon OE ankues. Megjithatë, mënyra e djegies së peletit dhe drurit është e ndryshme sepse për të përfutur masën e peletit, druri duhet të kalojë në procese përpunimi duke i shtuar komponentë tjerë dhe për djegien e peletit duhen stufa të veçanta të cilat janë të dedikuara vetëm për pelet. Po ashtu, gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Paneli Shqyrtues ka shqyrtuar dhe analizuar përgjigjen e autoritetit kontraktues, ku ka sqaruar se autoriteti kontraktues ka shpallë dy tender veç e veç: “Furnizimi i të gjitha shkollave me dru zjarri” dhe “Furnizimi me pelet për shkollat, QKMF-në dhe

DKRS-në”, ku referencat lypsen për secilën veç e veç dhe janë kërkuar referenca ekskluzivisht vetëm për dru (të natyrës së njëjtë). Furnizim me pelet, janë kërkuar referenca të natyrës së njëjtë vetëm për pelet. Andaj, Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të referencave të OE ankues, vjen në përfundim se dorëzimi i referencave të dorëzuara nga OE ankues sipas kërkesës së AK-së, nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, se autoriteti kontraktues me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka vepruar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



Vendimi t’i dorëzohet:

- 1x1 AK “KK-Lipjan”;
- 1x1 OE “AOME” SH.P.K ; N.T.SH“Tini” –Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.